

**RAPORTI:**  
**PËRMBLEDHJE NGA DISKUTIMET E GRUPIT TË FOKUSIT MBI**  
**IMPLEMENTIMIN E DIMENSIONIT SOCIAL TË PROCESIT TË**  
**BOLONJËS NË KOSOVË**

**Prishtinë , Qershor 2015**

Hartuar nga Xhavit Rexhaj

Me kontribute nga

Arianit Krasniqi, Louise Sperl dhe Veronika Nitsche (WUS Austria)

Komente shtesë me shkrim janë ofruar nga:

Muhamet Arifi (Balkan Sunflowers), Lulavere Behlili-Kadriu,

Enesa Kadic (MASHT) dhe Mimoza Paçaku (RrGK)

I.)	<b>HYRJE</b> .....	4
	Rëndësia e politikave kombëtare.....	4
	Gjetjet nga hulumtimet sekondare .....	6
	Një vështrim i ngushtë i dimensionit social .....	6
	Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetit pakicë, vajzat, dhe personat nga zonat rurale .....	7
II.)	<b>DISKUTIMET E GRUPEVE TË FOKUSIT</b> .....	9
	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E DISKUTIMEVE TË GRUPIT TË FOKUSIT</b> .....	9
III.)	<b>PIKAT KRYESORE NGA DISKUTIMI I GF ME AUTORITETET, UDHËHEQËSIT E LARTË TË UNIVERSITETIT DHE OSHC</b> .....	10
	a.) Të kuptuarit e konceptit të Dimensionit Social në arsimin e lartë .....	10
	b.) Kategoritë e papërfaqësuar në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës .....	10
	c.) Situata aktuale për sa i përket dimensionit social në arsimin e lartë në Kosovë .....	10
	d.) Masat konkrete në vend për implementimin e aspekteve që kanë të bëjnë me Dimensionin Social të Procesit të Bolonjës .....	11
	Praktika e mirë nga Universiteti i Prizrenit .....	12
	e.) A e pasqyron popullsia studentore strukturën e popullsisë së Kosovës? .....	12
	f.) Të dhënat e disponueshme për studentët nga grupet e cënueshme .....	13
	g.) Përfundimet .....	13
IV.)	<b>PIKAT KRYESORE NGA DISKUTIMET E GRUPIT TË FOKUSIT ME MENAXHMENTIN E UNIVERSITETIT DHE PERSONELIN MËSIMDHËNËS</b> .....	15
	a.) Infrastruktura, kushtet e punës dhe përkrahja financiare e synuar .....	16
	b.) Personat me nevojë të veçanta arsimore.....	16
	c.) Personat e prekur nga lufta.....	17
	d.) Disponueshmëria e të dhënave dhe informacioneve .....	17
	e.) Pjesëtarët e komuniteteve etnike .....	17
	f.) Çështje të tjera .....	18
	g.) Përfundimet .....	19
V.)	<b>PIKAT KRYESORE NGA DISKUTIMI I GRUPIT TË FOKUSIT ME STUDENTËT</b> .....	20
	a.) Hyrje .....	20
	b.) Diskriminimi i pretenduar dhe abuzimet e kuotës së pakicave dhe bursat .....	21
	c.) Disponueshmëria e kufizuar e programeve të studimit në gjuhët e komuniteteve të pakicës .....	22
	d.) Roli i unioneve studentore .....	23
	e.) Njohja e diplomave dhe shkollimit .....	23
	f.) Bursat dhe format e tjera të mbështetjes financiare .....	23

g.) Studentët me nevoja të veçanta arsimore .....	24
h.) Punësimi dhe studimet e mëtejshme .....	24
i.) Përfundime .....	24
<b>VI.) REKOMANDIMET E BAZUARA NË GJETJET NGA DISKUTIMET E GRUPIT TË FOKUSIT .....</b>	<b>25</b>
Rekomandimet e bazuara në rezultatet nga diskutimet e grupit të fokusit .....	25
a) Rekomandimet që i adresohen ligjvënësve dhe autoriteteve të arsimit të lartë: .....	25
b) Rekomandimet që i adresohen institucioneve të arsimit të lartë dhe personelit mësimor ...	26
c) Rekomandimet që i adresohen organizatave të shoqërisë civile .....	27
d) Rekomandimet që i adresohen studentëve / unioneve studentore .....	27
<b>ANEKSI I: PYETJET UDHËZUESE PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMEVE TË GRUPIT TË FOKUSIT .....</b>	<b>29</b>
<b>ANEKSI II: TË DHËNAT MBI DIMENSIONIN SOCIAL TË PROCESIT TË BOLONJËS .....</b>	<b>35</b>

## I.) HYRJE

Koncepti i Dimensionit Social të arsimit të lartë u zhvillua për herë të parë në kuadër të Procesit të Bolonjës në Komunikatën e Pragës të vitit 2001 dhe në përgjithësi, i referohet **qëllimit të heqjes së pabarazive për qasje në arsimin e lartë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë** (EHEA): hyrja, pjesëmarrja dhe përfundimi i arsimit të lartë nga ana e trupit studentor duhet të pasqyrojë diversitetin e popullsisë. Kjo vjen me një nevojë për kushte të përshtatshme për studentët në mënyrë që ata të mund të përfundojnë studimet e tyre pa pengesa që lidhen me prejdardhjen e tyre sociale dhe ekonomike. Dimensioi social përfshin masat që duhet të ndërmerren nga qeveritë për të ndihmuar studentët, sidomos ata nga grupet e pafavorizuara sociale, në aspektet financiare dhe ekonomike dhe për t'i pajisur ata me udhëzime dhe shërbime të këshillimit me qëllim të zgjerimit të qasjes. Kjo është gjithashtu në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi të drejtën për arsimim: Sipas Konventës Ndërkombëtare të OKB-së mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR), e drejta për arsimim përfshin një detyrim për të zhvilluar qasje të barabartë për të gjithë në arsimin e lartë.

Në dekadën e fundit, numri i studentëve të arsimit të lartë në Kosovë është trefishuar nga 28.832 në vitin 2004/2005 në mbi 107,000 në vitin 2014. Gjatë periudhës së njëjtë ka pasur një rritje dukshme të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) - ndërkohë që ishte vetëm një Universitet publik i Prishtinës në vitin 2001, aktualisht janë gjashtë universitete publike dhe njëzet e pesë IAL jopublike me mësim në gjuhën shqipe dhe një universitet publik në pjesën veriore të Mitrovicës me mësim në gjuhën serbe. Një rritje e IAL, megjithatë, nuk shpjgohet automatikisht në qasje efektive dhe të barabartë në arsimim për të gjithë, duke përfshirë edhe për personat nga grupet e cënueshme dhe të marginalizuara. Në fakt, **pengesat strukturore siç janë varfëria, stereotipet e ngulitura apo diskriminimi indirekt** potencialisht mund të pengojë qasjen efektive në arsim për të gjithë. Deri më tani, në Kosovë i është kushtuar shumë pak vëmendje çështjes nëse personat nga grupet e marginalizuara mund t'i qasen në mënyrë efektive arsimit të lartë.

### Rëndësia e politikave kombëtare

Deri në vitin 2009, vendet në Procesin e Bolonjës u kërkuan të elaborojnë **strategjitë kombëtare për Dimensionin Social**, duke përfshirë planet e veprimit dhe masat për të treguar ndikimin e tyre. Strategjitë duhet të fillojnë me identifikimin e grupeve të mundshme të papërfaqësuar. Një analizë e strategjive ka treguar marrëveshje të konsiderueshme në mesin e vendeve raportuese se disa ose të gjitha grupet e mëposhtme janë të papërfaqësuar në arsimin e lartë:

- Grupet me prejardhje të ulët socio-ekonomike,
- Emigrantët (më pak të arsimuar) dhe minoritetet kulturore,
- Studentët me aftësi të kufizuara,
- Studentët jo-tradicionale (studentë të pjekur, studentët me kualifikime të huaja),
- Studentët femra-meshkuj (balanca gjinore).

Si pjesë e raporteve të tyre kombëtare në Procesin e Bolonjës, edhe vendet pjesëmarrëse nga EIJ kanë dhënë kontribute të tilla (IRJ e Maqedonisë, Serbia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria

– shih <http://www.ehea.info/article-details.aspx?ArticleId=86>).<sup>1</sup> Meqë Kosova zyrtarisht nuk është pjesë e EHEA, një strategji e krahasueshme deri më tani nuk është elaboruar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e standardeve të Bolonjës dhe faktin se dimensionin social deri më tani ka tërhequr vëmendjen të kufizuar në Kosovë - pavarësisht rëndësisë së saj të fortë për vendin - përpjekjet brenda HigherKOS aktualisht janë duke u zhvilluar **për të mbledhur të dhëna relevante për Kosovën** në përputhje me informacionin e dhënë mbi Dimensionin Social nga vendet anëtare në Procesin e Bolonjës, si pjesë e **Strategjive të tyre Kombëtare mbi Dimensionin Social**.

Bazuar në një përmbledhje të burimeve kryesore, është bërë një hulumtim i shkurtër dytësorë - duke treguar për çështjet kryesore të cilat janë marrë për formulimin e **Udhëzimeve për Intervistat e Grupit të Fokusit. Midis 11 dhe 13 marsit**, në Prishtinë janë kryer **tre Intervista të Grupit të Fokusit (IGF) mbi Dimensionin Social** të Procesit të Bolonjës. Të gjithë 19 pjesëmarrësit në IGF kanë përfshirë personelin mësimdhënës të arsimit të lartë, menaxhmentin e universitetit, autoritetet e arsimit, OSHC-të dhe studentët nga komunitetet boshnjake, rome dhe turke.

IGF kanë pasur për qëllim **stimulimin e një debati në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)** mbi Dimensionin Social të Procesit të Bolonjës dhe **identifikimin e rekomandimeve për të forcuar Dimensionin Social** të arsimit të lartë të Kosovës.

Pyetjet e adresuara në IGF kanë përfshirë si në vijim:

- **Cilat grupe mund të konsiderohen si të marginalizuara në Kosovë (në përgjithësi)?**
- **Cilat grupe janë të papërfaqësuar në arsimin e lartë?**
- **Cilat janë disa nga pengesat me të cilat ata ballafaqohen?**
- **Çfarë masash mund të merren për të përmirësuar qasjen në arsimin e lartë për grupet e marginalizuara?**

Analiza e rezultateve të përgjithshme nga IGF është konsoliduar në këtë raport dhe do të paraqitet në një **ngjarje të shpërndarjes** (mundësisht në qershor 2015), për të cilën të gjithë pjesëmarrësit në IGF do të ftohen. Analiza gjithashtu synon të **identifikojë pikat e hyrjes / rekomandimet për programet e ardhshme** me qëllim të përfundimit të Dimensionit Social të arsimit të lartë në Kosovë. Varësisht nga pranimi i akterëve kryesorë, veprimi potencial pasues brenda programeve të ardhshme mund të përfshijë intervenimet:

- I përshtatur për të **adresuar pengesat e zgjedhura për personat nga grupet e cënueshme në qasjen dhe përfundimin e arsimit të lartë** - siç është identifikuar nga pjesëmarrësit në IGF (p.sh. mentorimin e studentëve, qasjen në informata, sigurimin e transportit etj)
- **I krijuar për të mbështetur zhvillimin e një Plani Kombëtar të Veprimit mbi Dimensionin Social** për Kosovën, i informuar nga praktikantët më të mira nga vendet anëtare të Bolonjës, duke i'u përshtatur kontekstit specifik të vendit.
- I dizajnuar për shpërndarjen e informacionit dhe ngritjen e vetëdijësimit mbi nevojën për politikën dhe veprimet e Dimensionit Social në të gjitha nivelet e arsimit të lartë.

---

<sup>1</sup> Ende - kjo është bërë në shkallë të ndryshme, në veçanti kur është fjala për identifikimin e masave dhe aktiviteteve specifike që i përgjigjen nevojave të grupeve të cënueshme. Përveç kësaj, masat për të nxitur pjesëmarrjen nuk shoqërohen rregullisht nga mekanizmat e monitorimit (p.sh IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia).

## Gjetjet nga hulumtimet sekondare

Hulumtimet sekondare, intervistat individuale dhe diskutimet në grupet e fokusit nuk kanë ofruar dëshmi të masave<sup>2</sup> të synuara, të përshtatura për grupet e papërfaqësuar në formën e shërbimeve akademike, sociale ose financiare siç është propozuar në kuadër të Dimensionit Social të Procesit të Bolonjës.

Pjesëmarrja e pjesëtarëve të studentëve të grupeve të papërfaqësuar në qeverisjen dhe organizimin e arsimit të lartë nuk ishte ekzistuese në literaturën e shqyrtuar dhe në intervistat e zhvilluara nga ekipi. Siç u theksua më lart, një qasje gjithëpërfshirëse do të mundësohej nga zhvillimi i një Strategjie Kombëtare gjithëpërfshirëse mbi Dimensionin Social, siç është zhvilluar nga Shtetet Anëtare të Bolonjës.

## Një vështrim i ngushtë i dimensionit social në arsimin e lartë në Kosovë

Dimensioni social në arsimin e lartë të Kosovës shihet ngushtë si një e drejtë për qasje në arsimin e lartë, me format e tjera të mbështetjes gjatë dhe pas procesit të studimeve të cilat kanë mbetur pak apo krejtësisht të krejtësisht pavërejtura. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011 - 2016 parashikoi rritje të pjesëmarrjes në arsimin e lartë të Kosovës 12 deri në 35 studentë në 1000 banorë deri në vitin 2016. Ky synim megjithatë është hasur në fillim të 2014 dhe tejkaluar në vitet e ardhshme për të arritur mbi 55 studentë në 1000 banorë në vitin 2014. Megjithatë, këto masa nuk janë shoqëruar me masa të tjera për të mbështetur performancën studentore, nivelet e diplomimit dhe punësimin.

## Cili është ndikimi i pjesëmarrjes së shtuar në arsimin e lartë?

Të dhënat e pakta të disponueshme nga zyra e statistikave të MASHT-it dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 2008 - 2013 për regjistrimin e studentëve dhe diplomimin në Universitetin e Prishtinës tregojnë se pjesëmarrja më ka shërbyer vetëm për të rritur shkallën e braktisjes dhe për të ulur numrin e përgjithshëm të diplomuarve që hyjnë në tregun e punës.

**Tabela 8: Regjistrimet e studentëve dhe diplomimi sipas viteve të studimit në Universitetin e Prishtinës**

Viti akademik	Nr. Total i studentëve	Hera e parë Viti 1	Hera e parë Viti 2	Hera e parë Viti 3	Të diplomuar
2012/2013	45879	13146	7598	6283	4,809
Femra	24761	6697	4290	3700	2,492
2011/12	47,070	15,612	10,249	7,322	4,496
Femra	25,308	7,920	5,800	4,580	2,476
2010/11	44,130	17,190	9,178	6,016	-
Femra	22,447	8,600	4,977	3,411	-
2009/10	37,839	13,888	7,122	5,429	-
2008/09	29,051	10,007	5,192	4,413	5,161
2007/2008	25840	8,261			2,973*

\*Të dhënat janë në dispozicion vetëm për të diplomuarit universitarë sipas sistemit të Bolonjës. Të dhënat mungojnë për të diplomuarit nga Niveli 6 dhe para programeve të studimit të Bolonjës.

Burimi: ESK: Statistikat Arsimore, 2009; Statistikat Arsimore 2014;

<sup>2</sup> Përfshirja e vetëm ishte Fondi për Arsimimin e Romëve që ka dhënë disa bursa për pjesëtarët e komunitetit rom, duke synuar këtë kategori të papërfaqësuar.

Tabela tregon se ka pasur një rënie në terma reale dhe nominale në nivelet e diplomimit në arsimin e lartë në Kosovë. Këto shifra tregojnë se pjesëmarrja e rritur jo nuk ka rezultuar në përmirësimin e mundësive për çdo kategori të popullsisë nga arsimi i lartë në Kosovë. Për shkak të mungesës së masave të veçanta që synojnë grupe të cënueshme dhe të papërfaqësuar, mund të konkludojmë se kjo situatë ka zvogëluar më tej mundësitë për këto grupe gjatë kohës së dhënë.

Për ilustrim, Ministria ofron kuotat e regjistrimit (rreth 170 vende) për komunitetet pakicë në gjuhën shqipe. Megjithatë, atyre nuk i është ofruar ndonjë mbështetje shtesë në formën e huave / bursave, kurset e gjuhës në gjuhën shqipe, përkrahje mentorimi, ose transport ose akomodimin gjatë studimeve të tyre. Situata nuk përmirësohet kur shikohet mbështetja e dhënë përtej studimeve të tyre pasi nuk ka shërbime të synuara në institucionet e arsimit të lartë për të diplomuarit që vijnë nga grupet e papërfaqësuar.

### Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetit pakicë, vajzat, dhe personat nga zonat rurale


Hulumtimi dytësorë ofroi një numër të gjetjeve interesante në lidhje me pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme zakonisht të kategorizuara si të papërfaqësuar dhe të cënueshme në Kosovë dhe vende tjera në Evropë. Të dhënat në lidhje me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komunitetit të pakicave variojnë nga 0.1 për qind në Universitetin e Gjakovës, me 1 për qind vetëm në Universitetin e Prishtinës, 4 për qind në Universitetin e Pejës, 7 për qind në Universitetin e Prizrenit (të dhënat janë të disponueshme vetëm për vitin 2011 / 2012), deri në 8 për qind në Universitetin e Gjilanit sipas agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK nga: Statistikat e Arsimit 2013/2014: 2014). Madhe edhe përqindja e lartë nominale e dhënë për Universitetin e Prizrenit është relativisht e ulët duke pasur parasysh përqindjen relativisht të lartë (mbi 18 për qind) e pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë jo-shqiptare dhe jo-serbe në këtë regjion.

Madje edhe ky nivel i përfaqësimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë duhet të merret me rezervë midis pretendimeve (të shprehura gjatë diskutimeve në grupit në fokus) rreth abuzimeve të kuotave të regjistrimit në programet e studimit në kërkesë të lartë në të gjitha universitetet publike.

### Pjesëmarrja e vajzave në arsimin e lartë

Hulumtimi i statistikave të disponueshme të arsimit në Kosovë ka ofruar disa rezultate interesante edhe në lidhje me pjesëmarrjen e studenteve femra në arsimin e lartë. Statistikat tregojnë se ka pjesëmarrje më të ulët të vajzave në ciklin master të studimeve, në krahasim me ciklin universitarë (me rreth 5%) në nivel kombëtar. Kjo mund të nënkuptojë se ekziston një tendencë të fuqishme që vajzat të braktisin karrierën e tyre akademike për t'u punësuar apo për t'u martuar dhe për të rritur fëmijët.

*Përqindja e studenteve femra në universitetet publike sipas niveleve arsimore (Indikatorët e Arsimit në Kosovë)*



Të dhënat e paraqitura në fotografitë e mësipërme përkrahen edhe nga statistikat e arsimit 2011-12 dhe nga ato të 2013-14 për Universitetin e Prishtinës (tregon një raport prej 54% në 46 në favor të vajzave në nivelin universitarë). Megjithatë, vetëm 25 për qind e 3517 studentëve total të regjistruar në studimet e nivelit master në vitin akademik 2013/2014 janë femra. Situata është e ngjashme në universitetet e tjera të reja, me një përjashtim të dukshëm të Universitetit të Prizrenit, duke iu referuar studimeve në nivelin universitarë.

Edhe pse gjeografikisht jo aq larg nga Universiteti i Prishtinës, të dhëna nga Universiteti i Prizrenit ofrojnë një pamje shumë të ndryshme në lidhje me pjesëmarrjen e studenteve femra në nivelin universitar. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2011-2012 është 2738 prej të cilave vetëm 29% janë femra. Në këtë vit akademik gjithsej 2774 studentë kanë ndjekur studimet në Universitetin e Prizrenit prej të cilave 38% janë femra. (Statistikat e Arsimit 2011-2012).

Kjo mund të shpjegohet përmes një vështrimi më të afërt në statistikat e arsimit për vajzat nga zonat rurale në arsimin parauniversitar në këtë rajon siç tregohet në një studim të kryer nga OJQ "Thesari". Hulumtimi i tyre thekson se nga 171 vajza që kanë përfunduar arsimin e ulët të mesëm në komunën e Dragashit në vitin shkollor 2011-2012 vetëm 81 kanë vazhduar arsimin e mesëm të lartë të vitin shkollor 2012-2013, ndërsa në të njëjtën periudhë në këtë komunë 167 djem kanë përfunduar arsimin e ulët të mesëm dhe 144 prej tyre vazhduan nivelin e mesëm të lartë. (Projekti mbi fushatën e ndërgjegjësimit për edukimin e grave në komunën e Dragashit financuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në ZKM, implementuar nga OJQ Thesari 2012).

Niveli i ulët i pjesëmarrjes së vajzave në Universitetin e Prizrenit në përgjithësi dhe për vajzat që vijnë nga zonat rurale, në veçanti ka të bëjë me konsideratat kulturore dhe tradicionale mes komuniteteve etnike jo-shumicë në këtë rajon.



## II.) DISKUTIMET E GRUPEVE TË FOKUSIT

### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E DISKUTIMEVE TË GRUPIT TË FOKUSIT

Gjatë marsit 2015 janë përgatitur dhe organizuar tre diskutime të grupe të fokusit, për të gjeneruar një diskutim mbi nivelin e implementimit të Dimensionit Social të Procesit të Bolonjës në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Siç u theksua në hyrje, diskutimet kanë përfshirë (i) përfaqësues të autoriteteve të arsimit, institucionet e arsimit të lartë dhe OSHC-të (ii) Personelin mësimdhënës dhe (iii) studentët e universiteteve publike të Kosovës. Diskutimet zbuluan ekzistencën e vështirësive të mëdha në rrjedhën e implementimit të parimeve të Dimensionit Social të Procesit të Bolonjës në Kosovë. Këto vështirësi përshkruajnë nëpër një varg të gjerë të çështjeve dhe aspekteve që kanë të bëjnë me Dimensionin Social në arsimin e lartë. Pjesëmarrësit në diskutimet e grupit të fokusit kanë përmendur politikën, çështjet financiare, institucionale dhe personale dhe dobësitë që ndikojnë negativisht dhe që pengojnë në rrugën e mundësive të barabarta për të gjithë në arsimin e lartë.

Një emërues i përbashkët i pikëpamjeve të shprehura nga të gjithë pjesëmarrësit e grupeve të fokusit është mungesa relative e informacionit, të kuptuarit dhe qartësisë në lidhje me Dimensionin Social të Bolonjës. Pjesëmarrësit treguan një mirëkuptim gradual të Dimensionit Social të Bolonjës si të drejtën për të hyrë në arsimin e lartë, si mbështetje financiare e ofruar për studentët, ose në disa raste, si një çështje e përfshirjes në arsimin e lartë. Fazat fillestare e diskutimeve të grupit të fokusit dha një përshtypje të arritjeve të rëndësishme në këtë fushë, por disa pyetje dhe analiza më të thella zbuluan të meta serioze që tejkalojnë të gjitha aspektet dhe nivelet e arsimit të lartë në rrjedhën e sigurimit të mundësive dhe përfitimeve të barabarta nga arsimi i lartë për të gjithë. Diskutimet rreth grupeve të papërfaqësuar treguan ngjashmëritë e kontekstit në Kosovë me ato të vendeve të tjera anëtare të Procesit të Bolonjës, por gjithashtu duke paraqitur një kategori shtesë në kontekstin e Kosovës: të rinjtë që vijnë nga familjet e prekura nga lufta e fundit në Kosovë. Grupet e fokusit edhe një herë theksuan pozitën e vështirë në të cilën është popullsia rome, dhe mungesën e dispozitës për kategoritë me nevoja të veçanta. Një tjetër gjetje e rëndësishme e diskutimeve – e cila gjithashtu konfirmoi gjetjet nga hulumtimi dytësorë - ishte se Kosovës i mungon një strategji kombëtare mbi Dimensionin Social të Bolonjës.

Përfaqësuesit e autoriteteve të arsimit dhe institucioneve të AL iu referuan mungesës së fondeve dhe kapaciteteve në institucionet e AL për të siguruar implementimin më të mirë të parimeve të Dimensionit Social në Kosovë, ndërsa mësimdhënësit, studentët dhe OSHC-të u ankuan për mungesën e politikave adekuate, përkrahjen institucionale dhe fondet për të njëjtin qëllim. Përveç kësaj, diskutimet gjithashtu zbuluan një sërë sfidash për personat nga grupet e cënueshme në rrugën e tyre drejt arsimit të lartë siç janë niveli i ulët i vetëdijësimit në mesin e popullsisë rurale lidhur me përfitimet e arsimit të lartë në përgjithësi, martesat e hershme (në veçanti e vajzave), mungesa e transportit, mungesa e dispozitës së shumëllojshme në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë, dhe mungesa e perspektivës dhe mundësive të punësimit për të diplomuarit e arsimit të lartë.

Fjalët kyçe të cilat më së shpeshti janë përmendur në të gjitha tre grupet e fokusit përfshinin politikën, financat, personat me nevoja të veçanta arsimore (SEN), komunitetet etnike, studentët romë, vajzat e komuniteteve pakicë nga zonat rurale, personat që vuajnë nga pasojat e luftës dhe bursat.

### III.) PIKAT KRYESORE NGA DISKUTIMI I GF ME AUTORITETET, UDHËHEQËSIT E LARTË TË UNIVERSITETIT DHE OSHC

#### a.) Të kuptuarit e konceptit të Dimensionit Social në arsimin e lartë

Një diskutim për të kuptuarit e konceptit të Dimensionit Social tregoi një njohuri dhe game të gjerë të pikëpamjeve dhe qasjeve dhe, në të njëjtën kohë, një mungesë relative të informacionit mbi Dimensionit Social të Procesit të Bolonjës. Në inputet e tyre fillestare, disa pjesëmarrës iu referuan Dimensionit Social në arsimin e lartë, si një koncept të mirëqenies sociale dhe e konsideruan angazhimin e tyre me fushën e arsimit të lartë si pjesërisht të kufizuar: "Që prej vitit të kaluar organizata jonë (shënim: një OSHC) nuk është marrë me arsim të lartë. Sa i përket Dimensionit Social, ne jemi fokusuar në aspektet etnike, demografike dhe gjinore "Një tjetër pjesëmarrës tha se ata e kanë parë Dimensionin Social të lidhur ngushtë me normat shoqërore:" Kemi të bëjmë me vajza të reja dhe me arsimimin e tyre. Prandaj ne i konsiderojmë normat sociale, si shumë të rëndësishme, pasi ne mendojmë se diskriminimi fillon atje. "Një tjetër pjesëmarrës shtoi se" *universiteti ynë duhet të organizojë programe studimi në gjuhën angleze, pasi universitetet tjera në botë e bëjnë këtë. Kjo do të zgjerojë pikëpamjet dhe mundësitë e studentëve.* "

Si të sakta që ato mund të jenë në segmente të caktuara, siç janë gjinia, normat shoqërore, ndërkombëtarizimi i arsimit, apo mbështetjet ekonomike dhe sociale të studentëve, këto perspektiva transmetojnë një qasje të fragmentuar të Dimensionit Social në arsimin e lartë. Ka pasur edhe pikëpamje më gjithëpërfshirëse mbi këtë dimension të Procesit të Bolonjës, siç janë, "Dimensioni Social është multi-dimensional, kryesisht përfshin sigurimin e mundësive të barabarta për qasje në arsimin e lartë për të gjitha kategoritë, duke përfshirë edhe ato etnike, sociale apo gjinore ..." Madje edhe pse kjo perspektivë e ka parë Dimensionin Social kryesisht si një çështje e qasjes në arsimin e lartë, kjo ende i afrohet përkufizimit të pranuar gjerësisht.

Ndarja e përkufizimit mbi Dimensionin Social e BFUG (shih gjithashtu Të dhënat mbi Dimensionin Social në Aneks) me pjesëmarrësit ka ndihmuar në orientimin e diskutimit në drejtim drejt një qasjeje më të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse të çështjes. Në të njëjtën kohë diskutimi fillestar mbi Dimensionin Social ka treguar qartë nevojën për përpjekje për ngritjen e vetëdijësimin në këtë drejtim në Kosovë.

#### b.) Kategoritë e papërfaqësuar në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës

Pjesëmarrësit u pajtuan lehtësisht për listën e ofruar që i'u ofrua atyre nëlidhje me kategoritë e papërfaqësuar në arsimin e lartë (shih gjithashtu Të dhënat mbi Dimensionin Social në Aneks), duke shtuar qasjen më specifike në arsimin e lartë dhe beneficionet prej saj nga popullsia rurale, vajzat në ato zona dhe nga anëtarët e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian. Më pas, diskutimi ka treguar edhe dy kategori më shumë në Kosovë, përkatësisht migrantët e kthyer dhe personat që vuajnë nga pasojat e luftës së vitit 1999 në Kosovë.

#### c.) Situata aktuale për sa i përket dimensionit social në arsimin e lartë në Kosovë

Kjo pjesë e diskutimit të grupit të fokusit në shumë mënyra ka reflektuar diskutimin mbi të kuptuarit e konceptit të Dimensionit Social në arsimin e lartë. Pjesëmarrësit nga autoritetet dhe institucionet e arsimit të lartë analizuan situatën aktuale nga perspektiva të veçanta, në të njëjtën kohë duke treguar

vetëdijësim për një qasje më tërësore në temë. Të pyetur në lidhje me planifikimin strategjik për çështjen, ata deklaruan se *"nuk ka pasur plan kombëtar në vend për implementimin e Dimensionit Social të Procesit të Bolonjës, por ka pasur një Strategji Kombëtare të Arsimit që ka mbuluar edhe sektorin e arsimit të lartë"*, duke shtuar se "ajo siguron përmirësimin e qasjes në arsimin e lartë për të gjitha kategoritë e popullsisë." Pjesëmarrësit e tjerë thanë se ata nuk kanë plane të veçanta për implementimin e Dimensionit Social, siç përshkruhet në përkufizimin BFUG, por që ata i kanë përfshirë aspekte që kanë të bëjnë me Dimensionin Social në planet e tyre të përgjithshme, duke ilustruar këtë me kuotat për pakicat etnike. Një pjesëmarrës përmendi Strategjinë Kombëtare për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, e cila përfshinte edhe segmentin e arsimit të lartë. Ai gjithashtu vazhdoi diskutimin për kuotat dhe pohoi se ka raste kur është abuzuar me sistemin e kuotave nga komuniteti shumicë dhe se strategjia në përgjithësi nuk është implementuar me sukses. Ose si një pjesëmarrës deklaroi: *"Mungesa e ligjeve, politikave dhe strategjive të përshtatshme apo implementimi i tyre joadekuat ka pasur një ndikim negativ në Dimensionin Social dhe si rezultat, të rinjtë nuk aplikojnë për studime apo edhe kur të regjistrohen, nuk mund të vazhdojnë studimet e tyre universitare."*

Pjesëmarrësit e përfunduan këtë pjesë të diskutimit duke rënë dakord se Kosova duhet të zhvillojë një Strategji Kombëtare për Dimensionin Social në arsimin e lartë si një mjet për të siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe t'i përgjigjet çështjeve të shumta në këtë fushë nëpërmjet masave të synuara.

#### d.) Masat konkrete në vend për implementimin e aspekteve që kanë të bëjnë me Dimensionin Social të Procesit të Bolonjës

Kur u pyetën në lidhje me masat konkrete të ndërmarra nga Ministria e Arsimit apo nga universitetet publike për implementimin e Dimensionit Social, pjesëmarrësit folën për një numër të aktiviteteve të drejtuara kryesisht në mundësimin ose rritjen e aksesit në arsimin e lartë, por duke prekur vetëm kalimthi mbi masat që ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e studimeve. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit raportuan një sërë masash siç janë kuota e regjistrimit të anëtarëve të pakicave etnike dhe skemat sociale që larguan tarifat e shkollimit për studentët që vijnë nga kategoritë ekonomike të pafavorizuara të popullsisë. Megjithatë, pavarësisht nga bursat për studentët e shkëlqyer të dhëna nga Universiteti i Prishtinës, këto masa nuk i shërbejnë qëllimit të përmirësimit të standardeve të diplomimit ose për të siguruar barazi midis kategorive të ndryshme.

Bazuar në raportet nga pjesëmarrësit, **kuotat e regjistrimit** të rezervuara për 170 pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, siç parashikohet nga MASHT-i për komunitetet jo-shumicë në Kosovë, janë abuzuar shpesh: *"Kjo ndodh për shkak se shpesh ekziston korrupsioni dhe ndërhyrjet në kuadër të institucioneve të Kosovës, ku anëtarët e komunitetit shumicë janë regjistruar si pjesëtarë të komuniteteve RAE, dhe kanë zënë vendin e tyre veçanërisht në programet e studimit me kërkesë të lartë, siç janë mjekësia, arsimit, arkitektura, et.j Unë mund të ofrojë dëshmi për rastet kur kemi ndërhyrje dhe procedurat duhet të fillonin përsëri."* Ky pjesëmarrës shtoi se: "Pavarësisht kuotës vjetore prej 170 vendeve në universitetet publike, nga hulumtimet dhe diskutimet tona me 12,000 persona nga komunitetet RAE, kemi mësuar se ka vetëm 138 studentë në nivelin universitarë dhe 4 studentë në nivelin master nga këto komunitete në universitetet publike." Kjo dëshmi ka treguar për mangësitë dhe dështimet serioze në implementimin e politikave kombëtare dhe dispozitave ligjore për komunitetet e pafavorizuara etnike në Kosovë. Megjithatë, një pjesëmarrës u shpreh se ekziston një trend pozitiv në zhvillim e sipër pasi ekzistojnë rreth 1.000 pjesëtarë të këtyre tri komuniteteve, që aktualisht ndjekin shkollimin e mesëm - një sinjal pozitiv për të ardhmen e afërt. Kjo është parë edhe si një motivim për të punuar për implementimin më të mirë të ligjeve në të ardhmen për të lejuar më shumë të drejta për

anëtarët e rinj të këtyre komuniteteve në sistemin e arsimit të lartë. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë për masat e synuara për të adresuar pengesat dhe për të shtuar pjesëmarrjen e grupeve të cënueshme në arsim tashmë në nivelin e shkollës së mesme.

#### Praktika e mirë nga Universiteti i Prizrenit

Një sërë masash pozitive janë raportuar nga Universiteti i Prizrenit, gjatë diskutimit në grupin e fokusit. Përveç regjistrimit të lirë për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve RAE, Universiteti i Prizrenit ka dhënë një numër të bursave për ta dhe ka kontaktuar me autoritetet e disa komunave për të siguruar kredi që do të lehtësojnë studimet e tyre. Nga ana tjetër, është arritur një marrëveshje me komunën e Prizrenit për të hequr shpenzimet e transportit për studentët nga grupet e papërfaqësuar. Përfaqësuesi i Universitetit të Prizrenit ka shtuar "Unë jam shumë i lumtur që certifikata e pare e diplomës që unë kam firmosur ishte certifikata për një vajzë - studente me nevoja të veçanta. Ne jemi të angazhuar në përpjekjet për të krijuar një mjedis më të mirë për studentët me nevoja të veçanta në universitetin tonë. Megjithëse, ne duhet të pranojmë se më shumë është bërë jashtë sesa brenda ndërtesave në heqjen e barrierave fizike ndaj lëvizjes së lirë." Njëkohësisht, ky universitet është i vetmi në Kosovë që organizon studime në tri gjuhë mësimore, duke përfshirë edhe në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke në disa programe të studimit. Kjo, sipas përfaqësuesve të Universitetit të Prizrenit, ndihmon për të mbajtur anëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë dhe mundëson integrimin e tyre në shoqëri. Universiteti i Prizrenit duket të jetë gati për të shërbyer si një institucion multi-etnik i arsimit të lartë duke u treguar i hapur për bashkëpunim dhe gatishmëri për ndryshim.

Përveç komuniteteve etnike, çështjet gjinore u shfaqën dukshëm gjatë diskutimeve në grupe. Një pjesëmarrës në diskutim deklaroi se: "ngacmimi seksual ekziston në institucionet tona, dhe në veçanti në universitete. Megjithatë, ekziston një mungesë e mekanizmave dhe masave disiplinore për autorët. Me fjalë të tjera, ne të gjithë e dimë se ky fenomen ekziston, por nuk trajtohet direkt dhe ne disi e kemi pranuar këtë si një çështje normale; kjo sipas raporteve nga vajzat që kanë dëshmuar raste të tilla." Ky pjesëmarrës vazhdoi që hulumtimi i tyre ka treguar prani të dukshme të stereotipeve në literaturën universitare dhe se ka raste kur profesorët përpiqen t'u shpjegojnë studentëve se si është një grua e ndershme dhe me moral, si është një grua e përdhunuar dhe kështu me radhë. Përveç kësaj, u theksua nevoja për tejklimin e stereotipeve dhe ndarjes gjinore sa i përket përzgjedhjes së profesioneve. Ky pjesëmarrës sugjeroi kampanja për ngritje të vetëdijes si dhe skema të bursave për rritjen e numrit të femrave në të ashtuquajturat profesione dhe programe studimore 'për meshkuj', siç janë fakultetet teknike, bujqësia dhe TIK-u. Të gjitha këto aspekte duhet të trajtohen në mënyrë më adekuate, në nivel institucional dhe kombëtar. Këto raste janë një pengesë e madhe për arritjen e barazisë gjinore dhe sigurimin e mundësive të barabarta në arsimin e lartë.

#### e.) A e pasqyron popullsia studentore strukturën e popullsisë së Kosovës?

Sipas Procesit të Bolonjës, hyrja, pjesëmarrja dhe përfundimi i arsimit të lartë nga trupi studentorë duhet të pasqyrojë diversitetin e popullsisë. Në Kosovë, më së paku të përfaqësuar në arsimin e lartë tradicionalisht kanë qenë personat me nevoja të veçanta arsimore (SEN). Megjithatë, sipas pjesëmarrësve në diskutimin e grupit të fokusit, situata është përmirësuar, gjë e cila u ilustrua edhe nga shembulli i një profesori me nevoja të veçanta. Pjesëmarrësit gjithashtu përmendën dy raste të personave të shurdhër të cilët aktualisht janë duke studiuar për shkallën e tyre master.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, ekzistojnë 37,000 pjesëtarë të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas (edhe pse - sipas vlerësimeve të - vetëm 22,000 mund të mbeten pas migrimit të fundit në vendet e BE-

së). Në këtë kontekst, parashtrihen pyetjet se sa prej pjesëtarëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas janë duke studiuar në institucionet e arsimit të lartë. Sipas mesatares prej 55 studentëve për 1000 banorë në Kosovë, duhet të ketë rreth 1100 studentë nga këto komunitete në universitetet në Kosovë (Shih: Rexhaj dhe Pupovci, "Qasja në Arsimin e Lartë në Kosovë" 2015 dhe Agjencia e Akreditimit, SER, 2014). Sipas të dhënave të paraqitura nga një pjesëmarrës, ka pasur rreth 170 studentë nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas në UP, numër në rënie për shkak të migrimit në më pak se njëqind ndoshta, që studiojnë si rezultat i kuotës. Për shkak të rasteve të deklaruara të abuzimit me sistemin e kuotave, pjesëmarrësit u shprehën se "disa prej tyre në fakultete me kërkesë të lartë mund edhe të jenë shqiptarë"

Nga numri i mbetur, një pjesë e madhe nuk studiojnë në gjuhën e tyre amtare. Kjo ofron një pamje të zymtë për gjendjen e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në arsimin e lartë në Kosovë<sup>3</sup>.

#### f.) Të dhënat e disponueshme për studentët nga grupet e cenueshme

Një llogaritje e numrit të studentëve nga grupet/komunitetet e cenueshme në system tregoi se një mungon një sistem i besueshëm për grumbullimin e të dhënave në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Një sistem vetëm tani është duke u krijuar në Universitetin e Prishtinës që do të japë të dhëna të modularizuara dhe specifike për kategori të ndryshme të studentëve. Universiteti i Prishtinës si dhe Universiteti i Prizrenit tani janë duke punuar në databazat e tyre dhe furnizimin e të dhënave - ndoshta edhe për komunitetet etnike dhe grupet sociale. MASHT-i është duke punuar në një SIMA për arsimin e lartë.

#### g.) Përfundimet

Pjesëmarrësit arritën në përfundimin se ekziston një legjislacion i mirë në vend, por që ekziston nevoja që ky legjislacion të implementohet në mënyrë më koherente dhe sistematike. Një mënyrë për të përmirësuar implementimin mund të jetë përmes një strategjie kombëtare për implementimin e Dimensionit Social të Bolonjës. Një strategji e tillë do të përcaktojë qëllimet e nevojshme, objektivat dhe masat për realizimin e tyre. Njëkohësisht, aktivitetet mund të kushtojnë, për të siguruar implementimin më të mirë të masave për të cilat është rënë dakord.

Pjesëmarrësit u pajtuan se çështjet e grupeve të papërfaqësuara në arsimin e lartë janë të ndërlidhura me ato të arsimit parauniversitar dhe me kulturën dhe traditat e familjes, duke bërë thirrje për masa më sistematike në këtë fushë. Pjesëmarrësit u pajtuan se për adresimin e këtyre çështjeve në arsimin e lartë tashmë është tepër vonë. Studentëve, së bashku me familjet e tyre, duhet t'u ofrohet mbështetje adekuate.

Shumica e pjesëmarrësve konstatuan se ekziston nevoja për lidhje më të mira midis teorisë dhe punës praktike për t'i bërë studimet më të rëndësishme dhe më tërheqëse dhe për të rritur kompetencat e studentëve, por edhe punësimin e tyre. Më shumë lidhje dhe bashkëpunim midis akademisë dhe

---

<sup>3</sup> Këto shifra u prezantuan nga një anëtar i këtyre komuniteteve. Të dhënat e disponueshme sipas Kolegjit AAB, megjithatë, treguan se ekzistojnë rreth 40 pjesëtarë të këtyre komuniteteve që studiojnë në Universitetin AAB në gjuhën shqipe në vitin 2015.

industrisë shihet si një mënyrë përpara për mundësimin e punësimit, por edhe për përmirësimin e mundësive për të gjithë studentët në një periudhë afatgjatë.

#### IV.) PIKAT KRYESORE NGA DISKUTIMET E GRUPIT TË FOKUSIT ME MENAXHMENTIN E UNIVERSITETIT DHE PERSONELIN MËSIMDHËNËS

Temat kryesore që u diskutuan me pjesëmarrësit në diskutimet e grupit të fokusit me menaxhmentin e universiteteve dhe stafin mësimdhënës, mbuluan(i) të kuptuarit e konceptit të dimensionit social të arsimit të lartë, (ii) grupeve e papërfaqësuar në arsimin e lartë në Kosovë, (iii) statusin quo në lidhje me implementimin e dimensionit social në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës, (iv) praktikat e mira dhe (v) sugjerimet dhe planet e mundshme institucionale për përmirësimin e gjendjes aktuale.

- (i) Diskutimi në lidhje me të kuptuarit e konceptit të Dimensionit Social në mesin e pjesëmarrësve tregoi një mungesë relative të informacionit në lidhje me këtë aspekt të Procesit të Bolonjës në Kosovë. Një deklaratë nga një pjesëmarrës pasqyron mendimet e shprehura mbi konceptin e dimensionit social, duke e parë atë si një *"çështje të gjerë që përfshinë një spektër të gjerë të çështjeve me të cilat ballafaqohen studentët dhe universitetet që përfshijnë grupe të ndryshme sociale dhe studentët që vijnë nga grupe të ndryshme sociale dhe me prejardhje të ndryshme."* Ky kuptim i përgjithshëm i konceptit ka lënë anash aspektet kyçe siç janë *mundësitë e barabarta dhe kategoritë e papërfaqësuar.* Inputet të tjera e panë dimensionin social në arsimin e lartë, si një çështje të qasjes, pjesëmarrjes ose si mbështetje e shtetit për mirëqenien sociale në arsim. Shkëmbimi i mëtejshëm i pikëpamjeve dhe pyetjet vijuese ndihmuan në ndërtimin e një mirëkuptimi të përbashkët të pjesëmarrësve për këtë koncept, i cili lehtësoi shumë diskutimin në vijim. Ndërtimi i një mirëkuptimi të përbashkët në lidhje me procesin ishte një tregues i gatishmërisë së personelit të universitetit për t'iu përgjigjur sfidave në ofrimin e mundësive më të mira për grupet e papërfaqësuar në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë.
- (ii) Pjesëmarrësit, megjithatë, treguan një mirëkuptim të përbashkët për atë se cilat janë grupet e papërfaqësuar në arsimin e lartë në Kosovë dhe për shkaqet për këtë situatë. Ata listuan *"grupe të ndryshme që vijnë nga shtresat e ndryshme shoqërore, duke përfshirë edhe ato me probleme familjare, persona me invaliditet, pakicat, personat nga grupet e marginalizuara dhe kohër e fundit të kthyerit si pasojë e valës së personave që emigrojnë tani në vendet e BE-së,"* në këtë listë pjesëtarët e tjerë të shtuar me marrëveshjen e personave plenarë (në veçanti vajzat) nga zonat rurale, studentët goranë, studentët që diplomojnë nga sistemi arsimor paralel në gjuhën serbe (për shkak të vështirësive me njohjen e diplomave të tyre), dhe personat dhe familjet që pësuan nga lufta e vitit 1999, si kategori e popullsisë të papërfaqësuar në arsimin e lartë në Kosovë. Kjo pikëpamje në shkallë të gjerë i përgjigjej listës së grupeve të papërfaqësuar ofruar nga moderatori.
- (iii) Një diskutim i gjallë u zhvillua rreth situatës aktuale në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë nga perspektiva e Dimensionit Social. Çështje dhe tema të ndryshme u diskutuan në këtë drejtim gjithashtu për të identifikuar shkaqet që qëndrojnë pas situatës aktuale. Temat më të shpeshta të diskutimit ishin: financat dhe kushtet e punës, programet e studimit, mbështetja institucionale, personat me nevoja të veçanta arsimore, kuota e regjistrimit, etj. Shumica e pjesëmarrësve u pajtuan se si pasojë, priorizimi është i nevojshëm në Dimensionin Social në arsimin e lartë dhe se ka nevojitet më shumë mbështetje institucionale për personelin e

universitetit për të promovuar Dimensionin Social dhe për të mbështetur njerëzit dhe studentët që kanë nevojë për mbështetje.

#### a.) **Infrastruktura, kushtet e punës dhe përkrahja financiare e synuar**

Janë kritike që universitetet të kryejnë rolin e tyre në fushën e Dimensionit Social të AL, ose sipas fjalëve të një pjesëmarrësi: *"Kjo është një çështje e mungesës së financave, por jo vetëm kaq. Ekziston një konvikt, fondet janë ndarë dhe konvitet duhet të aktivizohej. Gjithashtu duhet bërë më shumë në infrastrukturë për studentët me nevoja të veçanta arsimore - diçka është bërë. Më shumë është bërë jashtë hapësirave se sa brenda. Ekziston edhe gatishmëria dhe niveli i vetëdijësimit të udhëheqësia."* Të pranishmit e tjerë u pajtuan, dhe shtuan masat më sistematike, siç janë" rishikimii i ligjit dhe politikave dhe nevoja që fondet të alokohen që synojnë veçanërisht implementimin e Dimensionit Social të arsimit të lartë ". Një pjesëmarrës tha se është shumë e vështirë për profesorët që të sigurojnë më shumë mbështetje individuale për studentët e tyre, pasi ata ndonjëherë mësojnë më shumë se 2000 studentë. Një nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës ofron shërbime akademike për më shumë se dhjetë mijë studentë në ambientet e përbëra nga jo më shumë se dhjetëra dhoma dhe teatro. "Çdo mendim për të siguruar mbështetje shtesë për studentët me nevoja të veçanta është pak problematik në kushtet aktuale të punës me klasa të mëdha dhe në mungesë të ambienteve të përshtatshme për procesin mësimor."

Pjesëmarrësit theksuan angazhimin e tyre në implementimin e masave përkatëse për Dimensionin Social, nëse ofrohet mbështetje e synuar dhe kushte më të mira pune. Gjatë diskutimit për çështjen e studentëve të cilët janë kthyer në studime si një mundësi e dytë pasi kanë munguar në arsimin e lartë gjatë viteve të nëntëdhjeta, një nga pjesëmarrësit, tha se: *"Në fakultetin tonë kjo varet nga profesorët individual të cilët e dedikojnë kohën e tyre vullnetarisht, për të siguruar më shumë mbështetje për studentët më të vjetër; profesorë të tjerë bëjnë të njëjtën gjë - ka raste të tilla. Problemi është se nuk ka kushte të mira të punës dhe mjaftueshëm dhoma madje as për konsultime, e lëre më për orare fleksibile. "Një tjetër pjesëmarrës shtoi se " Ka edhe anëtarë të komunitetit në mesin e studentëve më të vjetër. Ato mund të ndihmojnë studentët më të rinj. Ne mendojmë se stafi është i gatshëm të mbështesë studentët nga grupet e cënueshme; kjo është një çështje institucionale; mësimdhënësit i përgjigjen këtyre nevojave, por ata nuk kanë mbështetje nga institucionet dhe autoritetet; kapaciteti i personelit është i kufizuar pa mbështetje shtesë. "*

#### b.) **Personat me nevoja të veçanta arsimore**

Një nga temat që tërhoqi vëmendje të madhe nga pjesëmarrësit ishte gjendja e personave me nevoja të veçanta arsimore. Diskutimi u zhvillua rreth temës për mbështetjen e ofruar atyre për qasjen në arsimin e lartë si dhe mbështetjen gjatë studimeve të tyre. Pati pëlqim të përgjithshëm se nuk është bërë mjaftueshëm për personat / studentët me nevoja të veçanta arsimore. Arsyet kryesore të identifikuara dhe diskutuara ishin mungesa e vetëdijësimit, mungesa e ekspertizës profesionale, dhe infrastruktura joadekuate. Pjesëmarrësit u shprehën se: *"Në Prishtinë asgjë nuk është duke u ofruar për studentët me nevoja të veçanta arsimore, jo vetëm objektet fizike por edhe sa i përket kurrikulës dhe materialeve*



mësimore. Në Universitetin e Prizrenit ata janë duke bërë shumë më tepër për personat me nevoja të veçanta arsimore me vështirësi fizike, në ndërtesat e reja të cilat janë duke u ndërtuar. "

Si përgjigje për këtë situatë, pjesëmarrësit u pajtuan se: "Shumë më tepër duhet bërë për studentët me nevoja të veçanta arsimore, jo vetëm për praninë fizike, por edhe për pjesëmarrje të plotë dhe komunikim më të mirë në të gjitha aspektet dhe aktivitetet në të dy universitetet," duke shtuar se "ekziston një vetëdijësim i rritur në mesin e mësimitdhënësve të cilët kanë bërë shumë trajnime për këtë aspekt ... dhe ata janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje, jo vetëm gjatë, por edhe para regjistrimit të tyre për të përmirësuar qasjen e tyre në arsimin e lartë. "

#### c.) Personat e prekur nga lufta

Një grup i personave të cilët u konsideruan si të cenueshëm, nga pjesëmarrësit gjatë diskutimit në grupin e fokusit dhe i cili nuk gjendet zakonisht në klasifikime të ngjashme në vende të tjera është katëgoria e personave dhe familjeve të cilët pësuan humbje dhe trauma gjatë luftës së vitit 1999. Këto çështje u shfaqën në krye vjeshtën e kaluar, kur anëtarët e këtyre familjeve të cilët nuk arritën të regjistrohen në UP dhe shoqatat e veteranëve të luftës nisën protestat kundër udhëheqësisë të universitetit. Pjesëmarrësit treguan vetëdijësim të madh për çështjen dhe deklaruan se: "është shumë e rëndësishme për të adresuar nevojat e këtyre personave pasi traumat e luftës dhe pasojat duhet të adresohen. Personat e prekur duhet të përkrahen që të kenë qasje në arsim, si mjete të integritetit dhe përmirësimit të mundësive të tyre në jetë, duke përfshirë 1200 studentë që nuk arritën të regjistrohen kohët e fundit. Në Universitetin e Prizrenit kemi pasur asnjë problem me kategoritë e luftës, sepse ne i regjistrojmë ata "" Një numër i madh i familjeve kanë vuajtur gjatë luftës së vitit 1999; pasojat ende ndjehen dhe ekziston nevoja që institucionet e AL të përballen me këtë fenomen dhe të ofrojnë mbështetje për pjesëtarët e këtyre familjeve. "

#### d.) Disponueshmëria e të dhënave dhe informacioneve

Në Kosovë ekziston një mungesë e rëndësishme e vërejtur sa i përket informatave për grupe të ndryshme të papërfaqësuar dhe të marginalizuara në arsimin e lartë. Të dhënat e disponueshme për grupet e papërfaqësuar janë të fragmentuara, me raste të mangëta dhe jo të krahasueshme midis institucioneve dhe me vendet e tjera. Një pjesëmarrës u shpreh në këtë kontekst: "Nuk ka asnjë dëshmi për studentët e marginalizuar dhe të papërfaqësuar - ne mësojmë rreth tyre, vetëm nëse ata vijnë dhe bisedojnë me ne për problemet e tyre." Një tjetër pjesëmarrës shtoi se "Ajo që është e dukshme nuk është një problem; problemet e vërteta fillojnë me çështjet që nuk janë të dukshme dhe nëse ata janë të gatshëm që të vijnë dhe të flasin me ne për çështjet e tyre. Në këto raste është e vështirë të regjistrohen dhe të mbahen dëshmitë e tyre dhe t'u ofrohet mbështetje e duhur." Si rezultat, ekziston një mungesë e të dhënave dhe informatave relevante që do të mundësojnë vendim-marrjen e informuar dhe përgjigjen e përshtatshme ndaj nevojave të grupeve të papërfaqësuar dhe të cenueshme në arsimin e lartë.

#### e.) Pjesëtarët e komuniteteve etnike

Çështja e pjesëtarëve të komuniteteve etnike është referuar dhe diskutuar në mënyrë të veçantë dhe si një çështje ndërsektoriale. Çështja e programeve të studimit të disponueshme për komunitetet boshnjake dhe turke, për shembull, është përmendur nga disa pjesëmarrës. Ata thanë se këto komunitete mund të studiojnë në gjuhën e tyre vetëm në një numër të vogël (kryesisht për arsimim për mësues) të programeve, që e bën të vështirë për ata të zgjedhin dhe të ndjekin qëllimet e tyre personale

të zhvillimit dhe karrierën. Ata që nuk duan të bëhen mësues, si rezultat, ose mund të studiojnë programe të biznesit dhe ekonomisë në Universitetin e Pejës, apo të aplikojnë për regjistrim për të studiuar në gjuhën shqipe, ku ka një zgjedhje të gjerë të programeve të studimit. Përveç zgjedhjes më të gjerë, një numër i pjesëmarrësve theksoi cilësinë më të mirë të studimeve në këtë gjuhë e cila - sipas pikëpamjeve të tyre - është kryesisht për shkak të kualifikimeve më të mira të personelit mësimdhënës.

Diskutimi tregoi se kjo zgjedhje më e gjerë, për nga natyra ka pasur pengesat e saj, kryesisht gjuhësore dhe administrative. Raportet e pjesëmarrësve theksuan mungesën e ndihmës dhe / ose mbështetjes gjuhësore. Ata gjithashtu kanë folur për thashethemet se kuota e regjistrimit në gjuhën shqipe për këto komunitete është abuzuar nga anëtarë të komunitetit shumicë të shqiptarëve. Kjo, disa pjesëmarrës pohuan, është bërë në mënyrë që përfaqësuesit shqiptarë të ofrojnë ryshfet për partitë politike të komuniteteve pakicë, për të lëshuar certifikata për përkatësinë e tyre të supozuar minoritare etnike. Pra, pavarësisht nga ofrimi i një numri të kufizuar të programeve studimore në gjuhën e tyre dhe kuotës të regjistrimit në gjuhën shqipe, këto komunitete mbështeten vetëm te vetja e tyre, nëse janë të interesuar për një dispozitë arsimore më të larmishme – e cila shpesh gjendet në vende të tjera ku ata mbeten pas studimeve (kjo çështje gjithashtu është diskutuar më detajisht në grupin e fokusit me studentë).

Çështja e grupeve të marginalizuara gjithashtu ka të bëjë me sistemin **paralel** arsimor - ku studentët ndjekin shkollimin e tyre parauniversitar në gjuhën serbe dhe në sistemin paralel. Përkundër mundësive të ofruara dhe fleksibilitetit të sistemit, ata kanë tendencë që të kenë vazhdimësi në arsimimin e tyre larg nga sistemi i arsimit në Kosovë. Kosova duhet t'i jap prioritet mbështetjes të këtyre studentëve në mënyrë që ata të përfundojnë arsimin e tyre në Kosovë. Kjo mund të bëhet përmes politikave më fleksibile, duke përfshirë mbështetjen financiare.

#### f.) Çështje të tjera

Pjesëmarrësit gjithashtu diskutuan për çështje si njohja e dokumenteve, arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, përdorimin e gjuhëve, punësimin, transportin, programet e studimit, etj

